

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"AUTO te DAJA" Sh.p.k.**

- Z. Elvis Koçi, datëlindje 03.01.1992 me nr Id.J20103085K qytetar shqiptar, me vendlindje në Semisht, Korce, dhe banim në Lagja Demir Bungo, Ndertesa 24, Hyrja 1, Elbasan 3001. Shqiperi

Kami vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "AUTO te DAJA" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Lagja "Brigada 17 Sulmuese" Pallati 103, Zona kadastrale 8522 Elbasan 3001, Shqipëri. 1001.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**

Shoqëria ka objekt veprimtarie si më poshtë:

- Dhenie me qera te makinave te perdorura.

-Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet apo kufizohet ne baze të vendimit të Asamblesë se Ortakeve.

**Neni 5 - Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 500,000 leke i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.

**Neni 6 - Kontributet**

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Z. Elvis Koçi, datëlindje 03.01.1992 me nr Id.J20103085K qytetar shqiptar, me vendlindje në Semisht, Korce, Shqiperi dhe banim në Demir Bungo, Ndertesa 24 hyrja 1, Elbasan 3001, të cilit i



## Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

## Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Elvis Koçi, datëlindje 03.01.1992 qytetar shqiptar, me vendlindje në Semisht, Korce, dhe banim në Lagja Demir Bungo, Ndertesa 24, Hyrja 1, Elbasan 3001, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

## Neni 9- Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

## Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

### ORTAKËT

Z. Elvis Asim Koçi

Elvis Koçi



Datë 06.11.2023